



SHKOLLA PROFESIONALE “BEQIR ÇELA” DURRËS

Adresa :Lagjia Nr 14 Shkozet Durrës, tel 052264528, bcelamt@yahoo.com, beqircela.edu.al

Nr 31.....Prot

Durrës më,31/01/2024

RAPORTI:

VETËVLERËSIMI I INSTITUCIONIT PERIUDHA , 2022-2023

KRYETARI I BORDIT SHKOLLËS

OREST ÇELO

DREJTOR I SHKOLLËS

FATMIR MERKURI



Pasqyra e lëndës

Pasqyra.....	2
Ekipi përgjegjës	3
Përmbledhje e vetëvlerësimit.....	3
Metodologjia.....	4
Të dhëna për institucionin.....	5
Kualifikimet.....	6
Vetëvlerësimi i institucionit.(Fushat, nënfushat, gjetjet).....	7-13
Gjykime dhe konkluzione	14-15
Vlerësimi.....	16
Rekomandimet.....	17
Plani i përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë.....	18-24

Përgatitur nga :

Ekipi përgjegjës i vetëvlerësimit

- | | | |
|--------------------|-----------|---|
| 1. Nazmi Kasmi | (kryetar) | Përgjegjës i Njësisë zhvillimit |
| 2. Mimoza Zhamo | (anëtare) | N/Drejtores e Shkollës , Teori Profesionale |
| 3. Manjola Sharkaj | (anëtare) | Kryetare e Departamentit Termohidraulike & Mekanikë |

Hartimi i raportit përfundimtar të VVB të shkollës u realizua me punën dhe mbështetjen e gjithë stafit të shkollës, me pjesëmarrje aktive të tyre në ekipin mbështetës shpërndarë në të 5 fushat. I falenderojmë për ndjenjën e përgjegjësisë dhe përkushtimin gjatë këtij procesi të rëndësishëm duke bërë gjetjet me dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar.

➤ PËRMBLEDHJE E VETËVLERËSIMIT

Në periudhën mesimorë 2022-2023 në shkollën tonë u zhvillua një proces mesimor dhe edukativ konform kërkesave dhe rregulloreve . Mësimi teorik u realizua në të dy godinat, ndërsa praktika profesionale për shkak të prishjes për rindërtim të disa repartëve të bazës prodhuese në disa kualifikime u planizua dhe realizua në bizneset e rajonit konform marrveshjeve të bashkëpunimit me to. Stafit mesimor u përkushtua për mbarëvajtjen dhe realizimin e procesit mesimor për arritjen e objektivave të përcaktuara në planin vjetor të drejtorisë në fillim të vitit shkollor 2022-2023 . Për këtë vit shkollor pjesë e vazhdueshme e punës së stafit mesimor ka qënë edhe mbështetja e procesit të vetëvlerësimit të shkollës për të pasqyruar sa më realisht arritjet dhe nevojat për përmirësim e parë kjo edhe në kuadër të procesit të Akreditimit të plotë të institucional .

Vlerësojmë se puna institucionale u vlerësua më tej me marrjen e Akreditimit të plotë 4 vjeçar 06 tetor 2023 - 05 tetor 2027.

Analiza SWOT

PIKA TË FORTA	PIKA TË DOBËTA
Zbatimi me korrektësi dhe efektivitet i të gjitha ligjeve, udhëzimeve, urdhërave institucionalë.	Mungesa e identifikimit të vazhdueshëm të organizatave OJF në rajonin tonë
Funksionimi i të gjithë organizmave të ngritura në shkollë, në mbështetje të gjithë veprimtarisë mesimorë edukative.	Bashkëpunimi josistematik me shoqërinë civile.
Gjithëpërfshirja në menaxhimin institucional	Përmirësimi i vazhdueshëm i veprimtarive të këshillimit të karrierës për rritjen e numrit të nxënësve në shkollë për të plotësuar objektivin e shkollës.
Klima pozitive për marrdhëniet dhe bashkëpunimi midis mesimdhënësve.	Mungon bashkëpunimi për përmirësimin e kurrikulave për arsimin postsekondar, materialeve mbështetëse dhe për përgatitjen profesionale të nxënësve.
Përgatitja shkencore dhe aftësitë teoriko – praktike profesionale të mesimdhënësve	Zhvillimit i aftësive dhe temave ndërkurrikulare për zbatimin e tyre gjatë procesit të nxënies nuk zbatohet nga të gjithë mesimdhënësit dhe sipas kërkesave .
Organizimi dhe zhvillimi i provimeve të nxënësve në të gjitha kualifikimet , me	Mungesa e teksteve të mirëfillta për lëndët e teorisë dhe të praktikës profesionale
	Plani ditor i mesimdhënësve pasqyrohet në mënyrë të përgjithshme.
	Mjetet didaktike e materiale të cilat janë të amortizuara dhe të pamjaftueshme për arritjen e rezultateve mesimorë në fund të orës së mësimi.
	Numri i kufizuar i repartëve të praktikës profesionale (për

profesionalizëm dhe korrektësi.	shkak të rindërtimit të tyre) Mungesa e shumëllojshmërisë së metodave për një vlerësim sa më objektiv të nxënësit Niveli i bashkëpunimit me institucione të arsimit <i>post sekondar</i> për zhvillimin profesional nuk është në objektivin/masën e dëshiruar.
MUNDËSI Forcimi i punës në organizmat e shkollës për rritjen e bashkëpunimit me komunitetin dhe shoqërinë civile. Bashkëpunimi me MEKI dhe projektin GIZ për përmirësimin dhe përmirësimin e bazës materiale dhe mjedisit fizik në shkollë. Krijimi i mundësive të reja për projektin Gjender për ta bërë më eficientë atë duke gjetur , rrugë , burime dhe promovime më të plota në drejtim të afrimit të femrave në shkollë. Përfshirja në mësimdhënie e aftësive të gjelbëra & digjitale. Përgatitja dhe kualifikimi i stafit për një mësimdhënie gjithëpërfshirëse, inovative, me fokus të nxënësve gjatë gjithë jetës.	RRËZIQE Largimet e nxënësve nga shkolla. Braktisja nga shkolla e nxënësve për arsye ekonomike dhe sociale. Pamundësia për përfitimin e fondeve për pajisjen me mjete didaktike, materiale dhe laboratorë të praktikës të shkollës.

➤ METODOLOGJIA

Proçesi i vetëvlerësimit nisi më datë 29 Shtator 2023 me ngritjen e ekipit përgjegjës dhe ekipit mbështetës të VVB nga drejtoria e shkollës bazuar në Udhëzimin Nr. 18, Datë 6.7.2018 .
Gjatë këtij proçesi janë përdorur metoda cilësore dhe sasore; .

Cilësore

Intervistat, bisedat me grupet e interesit, takime, mbledhje dokumentave që lidhen me fushat e vetëvlerësimit, vëzhgimet e ndryshme ,përpunimi i gjetjeve.etj.

Sasore

Pyetësorët me pyetje të hapura dhe të mbyllura, listë kontrollet.

Për të përmbushur kriteret e vlerësimit janë përdorur teknikat e vëzhgimit, intervistat, bisedat, anketat, pyetësorët dhe listë kontrollet. Në vijim të punës së kryer nga ekipet janë mbledhur, regjistruar, dhe analizuar të gjitha materialet që përfshijnë planet e shkollës ,dokumentacionet administrative, analizat dhe raportet e shkollës . Në bazë të përpunimit të tyre janë përfutur rezultatet përfundimtare të vetëvlerësimit të cilat janë pasqyruar në platformën <https://scvet.al>. Ekipi përgjegjës dhe ai mbështetës i vetëvlerësimit të institucionit ka realizuar përpunimin sasior dhe cilësor të të dhënave të mbledhura gjatë periudhës 11.10.2023 - 22.12.2023 duke arritur në përfundimet e përfutura për të gjitha fushat dhe nënfushat . Përpunimi i të dhënave të proçesit të vetëvlerësimit sipas 5 fushave u bë i mundur me mbështetjen e platformës digjitale: <https://scvet.al> dhe nxjerrja e raporteve per fushat perkatëse prej tij.

Për realizimin e proçesit të vetëvlerësimit u ndoqën këto hapa pune:

Ngritja e ekipit përgjegjës të Vetëvlerësimit ,Urdhëri drejtorit të shkollës Nr.427, prot , Nr.27 Datë 29.09.2023
Ngritja e ekipeve mbështetëse dhe ndarja e detyrave (Përgjegjësit e ekipeve mbështetëse) 02.10.2023
Hartimi i planit te punës të vetëvlerësimit për 5 fushat e veprimtarisë dhe miratimi më 10 .10.2023
bazuar në kalendarin e veprimtarive , zbatimi i procesit të vetëvlerësimit u krye 10 .10 - 22 .12.2023.
Gjetja e të dhënave dhe përpunimi i tyre në *platformën digjitale:* [https://scvet.al/](https://scvet.al) 08 .01 – 15.01.2024

➤ TË DHËNA PËR INSTITUCIONIN



Emblema e Institucionit

Emri i shkollës: Shkolla Profesionale ” Beqir Çela “
Adresa : Lagja 14 , Shkozet , Durrës . Telefoni 052 264 528,
e-mail: bcelamt@yahoo.com
Website: <https://beqircela.edu.al/> fb,Instagram.

Viti i ndërtimit: 1961 , 2018

Sipërfaqja e laboratorëve dhe klasave të teorisë (A+B) :6090 m²

Sipërfaqja e reparteve të praktikës : 1943 m²

Sipërfaqja e ambienteve sportive. Palestra : 360 m²

Ambjenti jashtëm : 640 m²

Numri i ambienteve të klasave mesimore : 47

Numri i stafit pedagogjik : 80

Psikolog : 1

Numri i personelit ndihmës: 12

Numri i reparteve 18

Biblioteka 1

Njesia e zhvillimit 1

Zyra e departamenteve 1

Salla e aktiviteteve 2

Dhome dentisti 1

Dhome mjeku 1

Ambjente zyrash 11

Numri i nxënësve 1213

Historik i shkurtër i shkollës

- Shkolla Profesionale “Beqir Çela” ka hapur dyert për herë të parë më datë 01 shtator 1961.
- Drejtimit e ofruara në vite ishin Peshkim, Ndërtim, Mekanik i përgjithshëm, Motorrist, Mekanizatorë.
- Në vitin 1993 u bë i mundur ristrukturimi i shkollës me ndihmën e fondacionit Sëisscontact.
- Gjatë viteve 2017-2019 u ndërtua godina e re e shkollës për shtimin e kapaciteteve, si dhe filluan punimet për rikonstruksionin e plotë të godinës ekzistuese dhe rikonstruksioni i pjesshëm i reparteve të bazës prodhuese.
- Në vitin mësimor 2009 -2010 , si rezultat i reformës arsimore, shkolla jonë punon me kurrikulat e reja me strukturën mësimore 2+1+1 për drejtimit Shmt, Elektroteknikë dhe Termohidraulikë ndërsa në strukturën kombëtare 2+2 , drejtimi i TIK.
- Në vitin 2013 - 2014 programi Albvet i KE bëri të mundur hapjen e 2 kurseve 1 vjeçare (Multimedia Postsekondar dhe Automekanike - Diagnostikim me kompjuter i automobilave)
- Në vitin 2019 u realizua ndryshimi i strukturës së shkollës nga projekt-pilot në strukturën kombëtare për drejtimit Shërbime Mjetesh Transporti dhe Elektroteknikë.
- Në vitin 2021 u hap për herë të parë drejtimi i ri Mekanik .
- Në vitin 2023 u hap për herë të parë Kursi 1 vjeçar Niv.V KSHK: Diagnostikim-menaxhim-ne-autoservis
- Më datë 06/07/2023 fillon procesi i optimizimit me Shkollën e mesme Profesionale “ 26 Marsi” Kavajë .
- Më datën 06.10.2023 shkolla mori Akreditimin e plotë 4 Vjeçar deri me 05.10.2027, për kualifikimet e afuara.

➤ KUALIFIKIMET PROFESIONALE QË OFRON SHKOLLA:

Specifikimet e drejtimeve që ka shkolla aktualisht

Mekanikë	(Niveli II,III,IV i KSHK)
Shërbime mjetesh transporti	(Niveli II i KSHK) (Niveli III i KSHK) (Niveli IV i KSHK)
Elektroteknik	(Niveli II i KSHK) (Niveli III i KSHK) (Niveli IV i KSHK)
Termohidraulik	(Niveli II i KSHK) (Niveli III i KSHK) (Niveli IV i KSHK)
TIK	(Niveli II i KSHK) (Niveli IV i KSHK)
“Diagnostikim menaxhim në autoservis”	(Niveli i V-të i KSHK- ^{së})

Kualifikimet profesionale të ofruara

Shërbime mjetesh transporti	Niv II-të KSHK,
Shërbime motorrike,	Niv III-të KSHK,
Shërbime xhenerike,	Niv III-të KSHK,
Shërbime elektroauto,	Niv III-të KSHK,
Shërbime mjetesh transporti	Niv IV-të KSHK,
Mekanikë ,	Niv II,III-të KSHK,
Elektroteknikë,	Niv II-të KSHK,
Instalim elektrike civil dhe industrial,	Niv III-të KSHK,
Riparim pajisjesh elektroshtëpiake ,	Niv III-të KSHK,
Elektromekanikë,	Niv III-të KSHK,
Elektroteknikë ,	Niv IV-të KSHK,
Termohidraulika	Niv II-të KSHK
Instalime-sisteme-ngrohese-ftohese	Niv III-të KSHK,
Termohidraulike	Niv IV-të KSHK,
Teknologji informacioni dhe komunikimi,	Niv II-të KSHK,
Mbështetje e përdoruesve të TIK	Niv IV-të KSHK
Zhvillim website	Niv IV-të KSHK

Statistika për nxënësit për vitin shkollor 2022-2023

Regjistruar	1213 nxënës, nga këta 1209 meshkuj, 4 femra
KLASA X-të	11 klasa paralele
KLASA XI-të	12 klasa paralele
KLASA XII-të	13 klasa paralele
KLASA XIII-të	13 klasa paralele

Përbërja sociale për vitin shkollor 2022-2023

Prindër të divorcuar	20
Nxënës përsëritës	25
Nxënës me sjellje problematike	3
Nxënës me tendencë përdorimi dd	4
Nxënës të komunitetit Rom/ Egjiptian	14
Familje me nivel të ulët ekonomik	90
Nxënës të talentuar/ të shkëlqyer në mësim	23
Nxënës shumë të dobët në mësim	2
Nxënës me aftësi të kufizuara(Fizike)	5
Nxënës me probleme të tjera shëndetësore	6
Nxënës jetim me status	28

Në vitin mësimor 2022-2023

- Numri i nxënësve regjistruar në shtator 1213
- Nxënës total shtator 1213, me 49 klasa mësimore .
- Nxënës të larguar gjithësej..... 189 ,
- Nxënës kalues..... 969,
- Mbetës qershor5.4 %,
- Kalueshmëria 94.63 dhe notë mesatare 6.80

➤ VETËVLERËSIMI I INSTITUCIONIT

Fushat, nënfushat, treguesi

Fusha 1 : Menaxhimi dhe drejtimi

Performanca e vetëvlerësimit Shumë mirë , 1.28

Fusha	Nenfusha	Treguesi	Niveli i vlerësimit	Piket
1.Menaxhimi dhe drejtimi	1. Gjithëpërfshirja	1.1. Drejtoria e IoAFP-së përfshin të gjitha organizmat e saj në menaxhimin e jetës së institucionit	Shumë mirë	1.4
		1.2. Drejtoria e IoAFP-së nxit punën në ekipe të personelit të saj.	Shumë mirë	1.3
	2. Plani afatmesëm i IoAFP-së	2.1. IoAFP zhvillohet përmes planit afatmesëm	Shumë mirë	1.4
	3. Plani vjetor i IoAFP-së	3.1. IoAFP zbaton planin vjetor.	Shumë mirë	1.3
	4. Plani i vëzhgimit të orëve mësimore	4.1. Drejtoria e IoAFP-së kryen vëzhgime sistematike në orë mësimore, për të nxitur progresin e nxënësve/kursantëve	Shumë mirë	1.3
	5. Plani i monitorimit të dokumentacioni institucional	5.1. Drejtoria e IoAFP-së monitoron gjatë gjithë vitit mësimor plotësimin e dokumentacionit zyrtar.	Shumë mirë	1.1
	6. Statistikat e IoAFP-së, regjistrimi dhe transferimi i nxënësve	6.1. IoAFP ka statistika të sakta dhe përdor procedura korrekte për regjistrimin dhe transferimin e nxënësve.	Shumë mirë	1.2
	7. Vetëvlerësimi/ Vlerësimi i brendshëm i IoAFP-së	7.1. IoAFP realizon vlerësimin e brendshëm të saj.	Shumë mirë	1.3

	8. Zhvillimi profesional i staf	8.1. IoAFP identifikon nevojat e staf për kualifikim dhe trajnim.	Shumë mirë	1.0
		8.2. IoAFP realizon planifikimin e trajnimit dhe mbështet kualifikimin e staf	Shumë mirë	1.2
		8.3. IoAFP kujdeset për shkëmbimin e përvojës së trajnimit dhe të kualifikimit të personelit.	Mirë	1.7
	9. Efektiviteti i burimeve njerëzore dhe financiare	9.1. IoAFP bën planifikimin e nevojave të saj për burime njerëzore.	Shumë mirë	1.2
		9.2. IoAFP realizon ndarjen e qartë të roleve dhe detyrave të personelit.	Shumë mirë	1.0
		9.3. IoAFP mundëson përfshirjen e staf ndihmës në jetën e saj.	Mirë	1.7
		9.4. IoAFP realizon përdorimin efektiv të financave të saj.	Shumë mirë	1.1
Vlerësimi për Fushën 1			Shumë mirë	1.28

➤ GJETJET

Nënfusha: 1.8 Zhvillimi profesional i staf

Treguesi:

1.8.3. IoAFP kujdeset për shkëmbimin e përvojës së trajnimit dhe të kualifikimit të personelit.

Shkolla në rrjetet profesionale të takimeve të drejtëpërdrejta dhe ato online me mesimdhënësit nuk kanë funksionuar me efektivitet .

Nënfusha: 1.9 Efektiviteti i burimeve njerëzore dhe financiare

Treguesi:

1.9.3. IoAFP mundëson përfshirjen e staf ndihmës në jetën e saj.

Shkolla ka vënë në dispozicion dy ambiente të shërbimit shëndetësor,por nuk ka staf mbështetës për kryerjen e këtij shërbimi .

Fusha 2 , Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi

Performanca e vetëvlerësimit: Mirë 1.52

Fusha	Nënfusha	Treguesi	Niveli i vlerësimit	Piket
2.Marrdhenia dhe bashkepunimi	1. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me qeverisjen qendrore, rajonale dhe vendore	1.1. IoAFP-ja bashkëpunon me institucionet qendrore që mbulojnë arsimin dhe formimin profesional	Shumë mirë	1.3
		1.2. IoAFP-ja bashkëpunon me institucionet lokale që mbulojnë arsimin dhe formimin profesional	Shumë mirë	1.2
		1.3. IoAFP-ja bashkëpunon me qeverisjen vendore	Shumë mirë	1.2
	2. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me	2.1. IoAFP-të bashkëpunojnë me komunitetin e biznesit	Mirë	2.0

	biznesin	2.2. IoAFP-të komunikojnë me biznesin me anë të Njësisë së Zhvillimit.	Shumë mirë	1.2
3. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me komunitetin dhe shoqërinë civile		3.1. IoAFP-ja bashkëpunon në mënyrë efektive me komunitetin përreth saj	Shumë mirë	1.5
		3.2. IoAFP-ja bashkëpunon me shoqërinë civile	Mirë	2.0
4. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi midis vetë IoAFP-ve dhe institucioneve arsimore		4.1. IoAFP-ja bashkëpunon me institucione analoge brenda dhe jashtë vendit	Shumë mirë	1.3
		4.2. IoAFP-ja zhvillon veprimtari të këshillimit të karrierës për rritjen e numrit të nxënësve/kursantëve në institucionet e AFP	Mirë	1.5
		4.3. IoAFP-ja bashkëpunon me institucione të arsimit post sekondar dhe atij të lartë për zhvillimin profesional të saj	Mirë	2.0
Vlerësimi për Fushën 2			Mirë	1.52

➤ **GJETJET**

Nënfusha: 2. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me biznesin

Treguesi:

IoAFP-të bashkëpunojnë me komunitetin e biznesit.

Shkolla nuk lëshon diploma/certifikata të përbashkëta me bizneset që ofrojnë kualifikim profesionale të njëjta .

Nënfusha: 3 Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me komunitetin dhe shoqërinë civile

Treguesi:

2.3.2. IoAFP-ja bashkëpunon me shoqërinë civile.

Mungesa e identifikimit të vazhdueshëm të organizatave OJF në rajonin tonë

Bashkëpunimi josistematik me shoqërinë civile

Nënfusha: 2.4. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi midis vetë IoAFP-ve dhe institucioneve arsimore

Treguesi:

2.4.2. IoAFP-ja zhvillon veprimtari të këshillimit të karrierës për rritjen e numrit të nxënësve/kursantëve në institucionet e AFP.

Përmirësimi i vazhdueshëm i veprimtarive të këshillimit të karrierës për rritjen e numrit të nxënësve në shkollë.

2.4.3.IoAFP-ja bashkëpunon me institucione të arsimit post sekondar dhe atij të lartë për zhvillimin profesional të saj

Mungon bashkëpunimi për përmirësimin e kurrikulave, materialeve mbështetëse dhe për përgatitjen profesionale të nxënësve.

Fusha 3 , Kurrikula e zbatuar

Performanca e vetëvlerësimit : Shumë Mirë 1.45

Fusha	Nenfusha	Treguesi	Niveli i vlerësimit	Piket
3.Kurrikula e zbatuar	1. Kurrikula në bazë shkolle të AFP-së	1.1. Plani i zhvillimit të orëve mësimore/Plani mësimor zbatohet në përputhje me kërkesat e Skeletkurrikulës së Kualifikimeve Profesionale.	Shumë mirë	1.0

	1.2. Programet e mësimdhënies teorike profesionale zbatohen në përputhje me kërkesat e Skeletkurrikulës së Kualifikimeve Profesionale.	Shumë mirë	1.0
	1.3. Programet e mësimdhënies së moduleve praktike profesionale zbatohen në përputhje me kërkesat e Skeletkurrikulës së Kualifikimeve Profesionale.	Shumë mirë	1.3
2. Kurrikula në Bazë Ofruesi të FP-së	2.1. Programet e kurseve të unifikuara, profesionale zhvillohen konform kërkesave të dokumenteve zyrtare		
	2.2. Plani i zhvillimit të kursit jo të unifikuar, profesional zhvillohet në përputhje me nevojat e tregut lokal dhe rajonal të punës, si dhe të burimeve njerëzore dhe materiale që zotëron institucioni.		
3. Kurrikula e formimit të përgjithshëm	3.1. Plani tremujor ose vjetor lëndor zbatohet në përputhje me kërkesat zyrtare të dokumenteve kurrikulare.	Shumë Mirë	1.4
	3.2. Plani ditor hartohet sipas rekomandimeve të kurrikulës duke synuar arritjen e rezultateve të të nxënësit nga nxënësit	Shumë Mirë	1.5
	3.3. Mësuesi harton në planin ditor dhe rezultate për zhvillimin e aftësive dhe temave ndërkurrikulare	Mirë	1.7
	3.4. Mësuesi realizon projekte kurrikulare që i ndihmojnë nxënësit të përpunojnë njohuritë e mësuara dhe të zhvillojnë më tej aftësitë ndërkurrikulare.	Mirë	1.7
4. Mbështetja për zbatimin e kurrikulës	4.1. Mësuesit përzgjedhin tekstet e nxënësve.	Mirë	1.5
	4.2. IoAFP është e pajisur në mënyrë të mjaftueshme me laboratorë dhe mjete mësimore për zhvillimin e lëndëve teorike.	Mirë	1.8
	4.3. IoAFP disponon mjedise të veçanta për realizimin e moduleve dhe të praktikave profesionale.	Mirë	1.8
5. Ekipi kurrikular i IoAFP-së	5.1. Ekipi kurrikular, ai lëndor dhe ai i instruktorëve në IoAFP luajnë një rol parësor në planifikimin dhe zbatimin e një kurrikule që përmbush kërkesat e kualifikimeve profesionale që ofron.	Shumë mirë	1.2
Vlerësimi për Fushën 3		Shumë mirë	1.45

Nënfusha: 3.3. Kurrikula e formimit të përgjithshëm

Treguesi:

3.3.3.Mësuesi harton në planin ditor dhe rezultate për zhvillimin e aftësive dhe temave ndërkurrikulare
Rëndësia e zhvillimit të aftësive dhe temave ndërkurrikulare kërkon përmirësimin e vazhdueshëm për zbatimin e tyre duke gjatë procesit të nxënies.

3.3.4. Mësuesi realizon projekte kurrikulare që i ndihmojnë nxënësit të përpunojnë njohuritë e mësuara dhe të zhvillojnë më tej aftësitë ndërkurrikulare.

Projektet ndërkurrikulare jo gjithmonë përmbajnë të gjitha kërkesat e kërkuara sipas rubrikave të përcaktuara.

Nënfusha: 3.4. Mbështetja për zbatimin e kurrikulës

Treguesi:

3.4.1. Mësuesit përzgjedhin tekstet e nxënësve.

Mungesa e teksteve të mirëfillta për lëndët e teorisë dhe të praktikës profesionale

3.4.2. IoAFP është e pajisur në mënyrë të mjaftueshme me laboratorë dhe mjete mësimore për zhvillimin e lëndëve teorike.

Laboratorët dhe mjediset janë të pamjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale (prishja e reparteve të praktikave për fillimin e investimit për ndërtimin e bazës së re prodhuese)

3.4.3. IoAFP disponon mjedise të veçanta për realizimin e moduleve dhe të praktikave profesionale

Laboratorët dhe mjediset janë të pamjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale (prishja e reparteve të praktikave për fillimin e investimit për ndërtimin e bazës së re prodhuese)

Fusha 4 , Mësimdhënia dhe të nxënët

Performanca e vetëvlerësimit : Mirë 1.56

Fusha	Nënfusha	Treguesi	Niveli i vlerësimit	Piket
4.Mësimdhënia dhe të nxënët	1. Plani ditor	1.1. Mësuesi/instruktori i programeve profesionale harton çdo ditë planin ditor në përputhje me dokumentet kurrikulare dhe sipas veçorive të nxënësve/kursantëve.	Mirë	1.9
		1.2. Mësuesi/instruktori harton planin e zhvillimit të moduleve të praktikës profesionale në përputhje me dokumentet kurrikulare dhe sipas veçorive të nxënësve/kursantëve.	Shumë mirë	1.3
	2. Rezultatet mësimore	2.1. Plani mësimor i zhvilluar mundëson arritjen e rezultateve të orës mësimore.	Mirë	1.8
	3. Parimet kryesore gjatë orës mësimore	3.1. Gjatë orës mësimore, mësuesi/instruktori përcakton si parësore përvetësimin nga nxënësit/kursantët të koncepteve dhe aftësive kryesore të lëndës/modulit/kursit dhe zbulimin e lidhjeve mes tyre.	Mirë	1.8
	4. Ana shkencore	4.1. Mësuesi/instruktori zotëron anën shkencore dhe aftësitë e domosdoshme praktike për zhvillimin e lëndës/modulit/kursit	Shumë mirë	1.3
	5. Baza materiale didaktike	5.1. Mjetet didaktike e materiale, të përdorura në orën mësimore, mbështetin të nxënët.	Mirë	1.9
	6. Mjedisi fizik	6.1. Mjedisi fizik i klasës ose i praktikës është i përshtatshëm, funksional dhe motivon të nxënët.	Mirë	1.7
	7. Metodologjia	7.1. Metodatat, teknikat dhe strategjitë e përdorura sigurojnë arritjen e rezultateve të orës mësimore.	Shumë mirë	1.1

8. Detyrat e shtëpisë	8.1. Mësuesi/instruktori planifikon detyrat e shtëpisë si vazhdim i procesit të nxënies së pavarur individuale ose në grup.	Mirë	1.5
9. Përsëritja	9.1. Mësuesi/instruktori realizon një përsëritje efektive me në qendër nxënësin/ kursantin	Shumë mirë	1.1
10. Mjedisi i sigurt për të nxënë.	10.1. Klima pozitive dhe besimi janë elemente të natyrshme të procesit mësimor.	Shumë mirë	1.4
11. Nxënësit/ kursantët me nevoja të veçanta	11.1. Procesi mësimor mbështet nxënësit/kursantët me nevoja të veçanta.	Mirë	1.9
Vlerësimi për fushën 4		Mirë	1.56

Nënfusha: 4.1. Plani ditor

Treguesi :

4.1.1.Mësuesi/instruktori i programeve profesionale harton çdo ditë planin ditor në përputhje me dokumentet kurrikulare dhe sipas veçorive të nxënësve/kursantëve.

Plani ditor i mësimdhënësve pasqyron në mënyrë të përgjithshme pa u zbatuar dhe përfshirë të gjitha kritere dhe specifika të veçanta.

Nënfusha: 4.2. Rezultatet mësimore

Treguesi :

4.2.1. Plani mësimor i zhvilluar mundëson arritjen e rezultateve të orës mësimore.

Zbatimi i fazave dhe i kohës së përcaktuar gjatë orës mësimore për arritjen e rezultateve mësimore në fund të saj.

Nënfusha: 4.3. Parimet kryesore gjatë orës mësimore

Treguesi :

4.3.1. Gjatë orës mësimore, mësuesi/instruktori përcakton si parësore përvetësimin nga nxënësit/kursantët të koncepteve dhe aftësive kryesore të lëndës/modulit/kursit dhe zbulimin e lidhjeve mes tyre.

Në procesin mësimor për mësimdhënësit duhet një thellim e mbështetje më konkrete në parimet kryesore të mësimdhënies gjatë këtij procesi.

Nënfusha: 4.5. Baza materiale didaktike

Treguesi :

4.5.1. Mjetet didaktike e materiale, të përdorura në orën mësimore, mbështetin të nxënë.

Mjetet didaktike e materiale të cilat janë të amortizuara dhe të pamjaftueshme për arritjen e rezultateve mësimore në fund të orës së mësimi.

Nënfusha:4. 6. Mjedisi fizik

Treguesi :

4.6.1. Mjedisi fizik i klasës ose i praktikës është i përshtatshëm, funksional dhe motivon të nxënë.

Numri i kufizuar i reparteve të praktikës profesionale(për shkak të rindërtimit të tyre)

Nënfusha 4.8. Detyrat e shtëpisë

Treguesi :

4.8.1. Mësuesi/instruktori planifikon detyrat e shtëpisë si vazhdim i procesit të nxënies së pavarur individuale ose në grup.

Planifikimi i detyrave të shtëpisë si vazhdim i procesit nuk bëhet sipas nivelit të nxënësve të klasës.

Nënfusha 4.11. Nxënësit/ kursantët me nevoja të veçanta

Treguesi :

4.11.1. Procesi mësimor mbështet nxënësit/kursantët me nevoja të veçanta.

Plane të personalizuara për këtë kategori nxënësish nuk realizojmë .

Nuk ka programe mësimore të personalizuara dhe materiale mësimore mbështetëse për nxënës me aftësi të kufizuara FIZIKE

Fusha 5 , VlerësimiPerformanca e vetëvlerësimit *Shumë mirë 1.25*

Fusha	Nënfusha	Treguesi	Niveli i vlerësimit	Piket	
5. Vlerësimi	1. Vlerësimi periodik i nxënësit/kursantit	1.1. Mësuesi/instruktori dokumenton vlerësimin për të nxënë të nxënësit/kursantit.	Shumë mirë	1.0	
		1.2. Mësuesi/instruktori zhvillon vlerësime me test/detyra përmbledhëse për të matur nivelin a rritjeve të nxënësive/kursantit	Shumë mirë	1.0	
		1.3. Mësuesi/instruktori realizon vlerësim të nxënësit/kursantit duke u bazuar në portoflin e tij.			
	2. Vlerësimi përfundimtar i nxënësit/kursantit	2.1. Mësuesi/instruktori kryen vlerësimin përfundimtar të nxënësit/kursantit	Shumë mirë	1.0	
		2.2. Mësuesi/instruktori vlerëson nxënësit në Provimet Përfundimtare të Nivelit I, II dhe III në Arsimin Profesional.	Shumë mirë	1.0	
	3. Procesi i vlerësimit	3.1. Mësuesi/instruktori ka një program të qartë për vlerësimin e nxënësve/ kursantëve.	Mirë	1.9	
		3.2. Mësuesi/instruktori bën vlerësimin e nxënësve/kursantëve për qëllime të ndryshme	Shumë mirë	1.4	
	4. Arritjet	4.1. Rezultatet e nxënësve në Maturën Shtetërore përputhen në nivele të kënaqshme me vlerësimin e bërë nga shkolla e AFP.	Mirë	2.0	
		4.2. Rezultatet e nxënësve/kursantëve në Provimet Përfundimtare të Niveleve/ Kurseve të unifikuara I, II dhe III në AFP, përputhen me vlerësimin e bërë gjatë procesit dhe vitit mësimor.	Shumë mirë	1.4	
		4.3. Mësuesi/instruktori informon prindërit për rezultatet e nxënësve dhe kursantëve.	Shumë mirë	1.0	
	5. Rivlerësimi	5.1. IoAFP-ja zhvillon procedura rivlerësimi për nxënësit/kursantët konform akteve ligjore.	Shumë mirë	1.0	
	6. Ankimimet	6.1. IoAFP-ja u përgjigjet ankimimeve të nxënësve/kursantëve për vlerësimin e tyre.	Shumë mirë	1.0	
	Vlerësimi për Fushën 5			Shumë mirë	1.25

Nënfusha: 5.3. Procesi i vlerësimit

Treguesi

5.3.1. Mësuesi/instruktori ka një program të qartë për vlerësimin e nxënësve/ kursantëve.

Mungon shumëllojshmëria e metodave për një vlerësim sa më objektiv të nxënësit.

Nënfusha:5.4. Arritjet

Treguesi

5.4.1. Rezultatet e nxënësve në Maturën Shtetërore përputhen në nivele të kënaqshme me vlerësimin e bërë nga shkolla e AFP.

Testet e zhvilluara në shkollë të hartohen për nga qartësia dhe shkalla e të kuptuarit në përputhje me testet e provimeve të maturës shtetërore.

➤ GJYKIME DHE KONKLUSIONE

Këtë vit procesi i vetëvlerësimit është kryer pas një procesi optimizimi. Gjatë vitit 2023 Shkolla e Mesme Profesionale Beqir Çela dhe Shkolla 26 Marsi, Kavajë kaluan në proces optimizimi. Shkolla e Mesme Profesionale Beqir Çela pas vendimeve të marra nga organet eprorë, menjëherë ka marrë masa për harmonizimin dhe integrimin e ish shkollës 26 Marsi. Këtë proces e ka pasuar një plan masash për përmirësimin e cilësisë. Shkolla është duke e ndjekur këtë plan, i cili ka nevojë për kohën e vetë për të dhënë efektet e dëshiruara. Rezultatet e këtij plani do të analizohen në procesin e vetëvlerësimit për vitin shkollor 2023-2024.

Por, për të analizuar gjendjen e dy ofruesve të optimizuar, Shkolla e Mesme Profesionale "Beqir Çela", Durrës ka qenë në komunikim të vazhdueshëm me stafin e shkollës "26 Marsi", për të mbledhur të dhëna për ecurinë e saj gjatë vitit shkollor 2022-2023, të cilat janë përmbledhur në një raport vetëvlerësimi.

Për këtë vit vetëvlerësimi, rezultatet përfshijnë përveç pikave të dobëta me synim përmirësim e shkollës Beqir Çela, por pasqyrohen gjithashtu dhe pikat e dobëta të mbartuara nga ish shkolla 26 Marsi të cilat kanë pasur efektet e veta gjatë këtij procesi.

F1 Menaxhimi dhe drejtimi (Shm,1.28)

Menaxhimi dhe drejtimi i shkollës në funksionimin e tij është mbështetur duke zbatuar Ligjet, Udhëzimet, rregulloret, kriteret dhe orientimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, MAS, AKPA-s, AKAFPK-së etj. Gjatë procesit të vetëvlerësimit është konstatuar që shkolla në organizmat dhe veprimtarinë e saj mbështetet gjërësisht në gjithpërfshirjen e faktorëve që ndikojnë në menaxhimin dhe drejtimin institucional. Është mbështetur puna koordinuese në ekipe dhe departamente mësimore . Kujdes i veçantë i është kushtuar mësimdhënësve të rinj në shkollë për mbështetjen e tyre në të gjithë veprimtarinë e tyre .Gjatë vitit ka monitoruar, nxitur dhe reklamuar punët për promovimin dhe regjistrimin e nxënësve në klasat e X^{ta}. Me efektivitet të lartë ka përdorur burimet financiare në mbështetje të veprimtarisë së procesit mësimor në shkollë . Gjithashtu edhe menaxhimi i burimeve njerëzore është kryer me efektivitet në shpërndarjen e ngarkesës mësimore .

Kërkesat e vazhdueshme të shkollës me mësimdhënës të rinj për teorinë dhe praktikën profesionale kërkon përmirësimin e vazhdueshëm në planifikimin dhe mbështetjen për trajnim dhe kualifikim e tyre.

F2 Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi (M,1.52)

Në veprimtarinë e saj shkolla është mbështetur në marrëdhënie të ngushta bashkëpunimi me organet e qeverisjes qendrore, vendore dhe rajonale.

Një faktor i rëndësishëm në mbarëvajtjen dhe përgatitjen e nxënësve nga ana profesionale është komuniteti i biznesit me të cilin shkolla ka një bashkëpunim të vazhdueshëm dhe cilësor.

Zhvillimi i dhe hapja e bizneseve të reja në rajon kërkon evidentimin e vazhdueshëm të tyre nga shkolla. Komuniteti i prindërvejanë të përfaqësuar në organizmat vendimmarrës të shkollës por nuk është pjesë e bashkëpunimit në analizat dhe nevojat e tregut të punës që bëhen nga shkolla .

Përmirësimi i vazhdueshëm i veprimtarisë së Njesisë së Zhvillimit ka ndikuar në rritjen e performancës dhe nivelit të cilësisë në shkollë.

F3 . Kurrikula e zbatuar (Shm,1.45)

Vepërimtaria në zbatimin e kurrikulës shkollore është mbështetur dhe ka funksionuar konform kërkesave , rregullave dhe udhëzimeve bazuar në orientimet e M.F.E, M.A.S, AKAFPK –^{së}
Nëpërmjet Njesisë së zhvillimit në shkollë, ekipeve lëndore dhe departamenteve është mundësuar zberthimi, hartimi dhe zbatimi i skeletkurrikulave të formimit të përgjithshëm dhe atij profesional për hartimin e planeve të mësimdhënies së teorisë dhe të praktikës profesionale.
Mësuesit zhvillojnë tema ndërkurrikulare në lëndët etyre por në hartimin e planeve ditore ata nuk paraqesin rregullisht rezultate për zhvillimin e aftësive ndërkurrikulare.
Mungesa e teksteve të të mirëfillta për teorinë dhe praktikën profesionale si dhe mjetet didaktike dhe baza materiale të amortizuara dhe të pamjaftueshme kanë ndikuar në rezultatet e të nxënësve .
Përgatitja shkencore dhe aftësitë teoriko – praktike profesionale të mësimdhënësve si dhe klima pozitive dhe marrdhëniet midis tyre ka ndihmuar në zbatimin korrekt te saj .
Organizimi dhe zhvillimi i provimeve të nxënësve në të gjitha kualifikimet , me profesionalizëm dhe korrektësi.

F4. Mësimdhënia dhe të nxënësve (M, 1.56)

Në procesin e mësimdhënies e të nxënësve shkolla ka punuar konform kërkesave për zhvillimin e planit mësimor për arritjen e rezultateve mësimore të nxënësve.
Ora mësimore është zhvilluar duke u mbështetur kryesosh në parimet kryesore të saj për përvetësimin e koncepteve dhe aftësive kryesore të lëndës.
Këtij procesi i ka shërbyer edhe përgatitja profesionale teoriko- praktike e mësimdhënësve si dhe klima pozitive dhe bashkëpunimi ndërmjet tyre.
Planifikimi i detyrave të shtëpisë si vazhdim i procesit të të nxënësve individual nuk është bërë sipas nivelit të nxënësve.
Klima pozitive dhe mjedisi i sigurtë në shkollë ndikon në rritjen e besimit dhe interesit ndaj shkollës. Një rëndësi të veçantë për mësimdhënien dhe mësimnxënien në shkollë kanë mjedisi dhe ambjentet në të cilat zhvillohet ky proces, theksojmë se në amjbejnet e teorisë jemi në dy ambjente të reja dhe bashkëkohore ndërsa një pjesë e ambjenteve të praktikave profesionale për shkak të degradimit po ribëhen dhe rikonstruktohen.

F5. Vlerësimi (Shm,1.25)

Gjatë procesit të vetëvlerësimit është konstatuar për këtë fushë se për vlerësimin e nxënësve përdoren instrumenta e metoda të larmishme për një vlerësim dhe vetëvlerësim real të nxënësve.
Hartimi i testeve të provimeve përfundimtare të niveleve dhe organizimi i tyre ka siguruar vlerësim cilësor në përmbushjen e kompetencave profesionale të kualifikimeve që ofron shkolla.
Pjesmarrja e përfaqësuesve të biznesit në vlerësimin e provimeve përfundimtare të niveleve si dhe gjatë praktikave profesionale në biznes ka ndihmuar në një vlerësim më profesional të nxënësve.
Komunikimi dhe informimi sistematik me prindërit ka ndihmuar në rritjen e rezultateve të nxënësve.
Si proces i rëndësishëm , vlerësimi i arritjeve të nxënësve bëhet duke përdorur metoda të ndryshme vlerësimi . Është i nevojshëm përmirësimi dhe pasurimi i vazhdueshëm i këtyre metodave.

Gjatë procesit të Vetëvlerësimit të brendshëm , nga gjetjet e përfituara arrimë në konkluzionin që institucioni në tërësi ka performuar brenda kuadrit ligjor duke pasqyruar rezultate të kënaqshme në gjithë funksionimin e tij.

➤ **VLERËSIMI**

Bazuar në raportet e përpunuara nga platforma digjitale, scvet.al , të të 5 fushave, përfituam vlerësimin përfundimtar të shkollës si më poshtë:

FUSHA	NIVELET E VLERËSIMIT	PIKËT
<i>F.1. Menaxhimi dhe drejtimi</i>	<i>Shumë mirë</i>	<i>1.28</i>
<i>F.2. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi</i>	<i>Mirë</i>	<i>1.66</i>
<i>F.3. Kurrikula e zbatuar</i>	<i>Shumë mirë</i>	<i>1.47</i>
<i>F.4. Mësimdhënia dhe të nxënësit</i>	<i>Mirë</i>	<i>1.56</i>
<i>F.5. Vlerësimi</i>	<i>Shumë mirë</i>	<i>1.32</i>
SI SHKOLLE	SHUMË MIRË	1.46

SHKOLLA “BEQIR ÇELA”:

VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM PËR TË 5 FUSHAT ËSHTË:

PERFORMANCA E VETËVLERËSIMIT

SHUMË MIRË 1.46

➤ REKOMANDIME

- ❖ Përmirësimi i punës në rrjetet profesionale nëpërmjet takimeve të drejtëpërdrejta dhe atyre online me mësimdhënësit sipas kualifikimeve profesionale.
- ❖ Forcimi i punës për identifikimin e vazhdueshëm të organizatave OJF në rajonin tonë
- ❖ Forcimi i bashkëpunimit me komunitetin e biznesit
- ❖ Forcimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile.
- ❖ Përmirësimi i vazhdueshëm i veprimtarive të këshillimit të karrierës për rritjen e numrit të nxënësve kryesisht vajzave në shkollë.
- ❖ Përmirësimi i kurrikulave dhe materialeve mbështetëse mësimore për përgatitjen profesionale të nxënësve.
- ❖ Përmirësimi i vazhdueshëm i zhvillimit të aftësive dhe temave ndërkurrikulare gjatë procesit të mësimdhënies.
- ❖ Vënia në efikasitet e laboratorëve dhe mjediseve me mjete mësimore didaktike për mbështetjen e kurrikulës.
- ❖ Përmirësimi i vazhdueshëm i punës për hartimin i planit mësimor si kusht i domosdoshëm për arritjen e rezultateve mësimore në mësimdhënie dhe mësimnxënie.
- ❖ Përmirësimi i metodave për vlerësimin sa më objektiv të arritjeve të nxënësve.
- ❖ Forcimi i bashkëpunimit me arsimin postsekondar për përmirësimin e kurrikulave, materialeve mësimore mbështetëse dhe aftësimin profesional të nxënësve për përgatitjen profesionale të tyre.
- ❖ Përfundimi brenda afateve i projektit të rindërtimit të bazës prodhuese për vënien në funksionim të reparteve të reja të praktikës profesionale .

PLANI I PËRMIRËSIMIT TË VAZHDUESHËM TË CILËSISË

FUSHA E VETËVLERËSIMIT : Menaxhimi dhe drejtimi

REKOMANDIMI		Përmirësimi i punës në rrjetet profesionale nëpërmjet takimeve të drejtëpërdrejta dhe atyre online me mësimdhënësit sipas kualifikimeve profesionale.				
Objektivi		<i>-Të përmirësojmë punën në lidhje me rrjetet profesionale</i>				
Treguesi i përmbushjes: Të gjitha drejtimet profesionale të kenë rrjetet e tyre.						
Nr	Veprimtaritë	Afate kohore	Personi përgjegjës	Metodologjia	Instrumenti matës	Vendndodhja
1	Krijimi i grupeve sipas kualifikimeve profesionale me focus pjesmarrja e tyre në takime të drejtëpërdrejta dhe online	Shkurt – shtator 2024	Psikologu i Ekipeve të lëndore dhe departamentet	Dokumentacioni i shkruar në dosje	Takime	Shkollë

REKOMANDIMI		Formi i punës për identifikimin e vazhdueshëm të organizatave OJF në rajonin tonë .				
Objektivi		<i>-Të identifikohen në mënyrë të vazhdueshme OJF për bashkëpunimin me shoqërinë civile.</i>				
Treguesi i përmbushjes: Lista e OJF që veprojnë në rajon						
Nr	Veprimtaritë	Afate kohore	Personi përgjegjës	Metodologjia	Instrumenti matës	Vendndodhja
1	-Krijimi i database-s për organizatat OJF që veprojnë në rajonin tonë.	Shkurt 2024	Psikologu i shkollës Koord.Karrierën	Plane pune	Evidenca	Shkollë rajon
2	-Takime të drejtëpërdrejta me përfaqësues të OJF ✓ Kryqi i kuq (Substancat narkotike) ✓ Programi Qëndro (UNICEF)	Janar – Qershor 2024	Psikologu i shkollës Koord.Karrierën	Plane pune	Evidenca	Shkollë rajon

FUSHA E VETËVLERËSIMIT : Marrdhëniet dhe bashkëpunimi

REKOMANDIMI		-Forcimi i bashkëpunimit me komunitetin e biznesit				
Objektivi		-Të forcojmë bashkëpunimin midis shkollës dhe komunitetit ,biznesit				
Treguesi i përmbushjes: Lista e bizneseve aktiv të të gjitha kualifikimeve që bashkëpunojnë me shkollën.						
Nr	Veprimtaritë	Afate kohore	Personi përgjegjës	Metodologjia	Instrumenti matës	Vendndodhja
1	Takime , vëzhgime, bashkëbisedime , intervista me komunitetin	Gjatë vitit 2024	Psikolog Njësia e Zhvillimit	Vizita në teren	Përpunim të dhënash Relacione, analiza	Teren Shkollë
2	Feedback nga Bizneset që veprojnë në rajon .	Mars 2024	Pergj B.prodhuës e Koord Biznesit në Njësi	Online	Përpunim të dhënash	Shkollë -Biznes
3	Organizimi i një tavoline pune me mentorët dhe drejtuesit e bizneseve , për problematikat dhe përmirësimin e punës për bashkëpunim më të suksesshëm.	Maj 2024	Drejtoria Njësia Zhvillimit	Takim i drejtëpërdrejtë	Njoftime Referate e bashkëbisedime nga pjesmarrësit	Shkollë

REKOMANDIMI		-Forcimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile				
Objektivi		-Të forcojmë bashkëpunimin me shoqërinë civile				
Treguesi i përmbushjes: Lista e organizatave të shoqërisë civile.						
Nr	Veprimtaritë	Afate kohore	Personi përgjegjës	Metodologjia	Instrumenti matës	Vendndodhja
1	Takime , vëzhgime, bashkëbisedime , intervista me shoqërinë civile. ✓ Shoqata gjender ✓ Qendra komunitare multifunksi onale “ RRASHBULL”	Gjatë vitit 2024	Psikolog Koord karrierës Marketing ut	Vizita në teren	Përpunim të dhënash Relacione, analiza	Teren Shkollë
2	Veprimtari psiko-edukative : “Diversiteti në shoqërinë tonë “	Shkurt 2024	Psikologu i shkollës	Diskutim i lirë + pyetësor	Pyetësor Përpunim të dhënash	Qendra komunitare multifunksi onale “ RRASHBU LL”

REKOMANDIMI		Përmirësimi i vazhdueshëm i veprimtarive të këshillimit të karrierës për rritjen e numrit të nxënësve kryesisht vajzave në shkollë.				
Objektivi		<i>-Të përmirësojmë edhe më tej veprimtaritë e këshillimit në karrierë për rritjen e numrit të nxënësve në shkollë.</i>				
Treguesi i përmbushjes: Rritja me 10% numrit të nxënësve në shkollë , Rritja me 5% i numrit të vajzave në vit të parë.						
Nr	Veprimtaritë	Afate kohore	Personi përgjegjës	Metodologjia	Instrumenti matës	Vendndodhja
1	Takim me nxënësit e klasave të IX-ta në shkollë të rajonit për edukimin dhe barazinë gjinore .	Mars-maj 2024	Psikologe shkollës Koord Edukimit në karrierë mesues	Vizita në teren	Përpunim të dhënash Relacione, analiza	Shkollë 9-vjeçare të rajonit
2	Takim me prinder dhe drejtues të shkollave 9-vjeçare .	Prill - Maj 2024	Ekipe të promovimit në shkollë	Takime të drejtëpërdrejta me vizita në shkollë	Relacione Analiza	Shkollat 9 - vjeçare

REKOMANDIMI		Forcimi i bashkëpunimit me arsimin postsekondar për përmirësimin e kurrikulave, materialeve mësimore mbështetëse dhe aftësimin profesional të nxënësve për përgatitjen profesionale të tyre.				
Objektivi		<i>Të rrisim frymën e bashkëpunimit me arsimin postsekondar</i>				
Treguesi i përmbushjes: Marrveshje bashkëpunimi						
Nr	Veprimtaritë	Afate kohore	Personi përgjegjës	Metodologjia	Instrumenti matës	Vendndodhja
1	Takime me përfaqësues të Arsimit PS (UAMD)	Qershor 2024	Drejtoria	Biseda të hapura , diskutime	Relacione përmbledhëse	Shkollë-UAMD

FUSHA E VETËVLERËSIMIT : Kurrikula e zbatuar

REKOMANDIMI		-Përmirësimi i kurrikulave dhe materialeve mbështetëse mësimore për përgatitjen profesionale të nxënësve.				
Objektivi		<i>-Të realizohet përmirësimi i kurrikulave dhe materialeve mbështetëse mësimore për përgatitjen profesionale të nxënësve duke përmirësuar punën në departamente për përgatitjen e materialeve mësimore profesionale.</i>				
Treguesi i përmbushjes: Materialet mësimore të drejtimit që ofron shkollë						
Nr	Veprimtaritë	Afate kohore	Personi përgjegjës	Metodologjia	Instrumenti matës	Vendndodhja
1	Diskutim për përmirësimin e kurrikulës shkollë dhe materialeve mësimore .	Gjatë vitit 2024	Kryetarët e departamenteve dhe ekipeve lëndore	Takime të drejtëpërdrejta	Procesverbale të takimeve Referimi perfundimtar.	Shkollë

REKOMANDIMI		-Përmirësimi i vazhdueshëm i zhvillimit të aftësive dhe temave ndërkurrikulare gjatë procesit të mësimdhënies.				
Objektivi		<i>-Të forcojmë bashkëpunimin midis mësimdhënësve në shkollë për realizimin e projekteve ndërkurrikulare.</i>				
Treguesi i përmbushjes: Të paktën në çdo lëndë të ketë një projekt ndërkurrikulare me ndërthurjen e disa lëndëve.						
Nr	Veprimtaritë	Afate kohore	Personi përgjegjës	Metodologjia	Instrumenti matës	Vendndodhja
2	Takim midis mësimdhënësve të shkollës për bashkëpunim mes tyre për projektet ndërkurrikulare me fokus : Aftësitë e gjelbra dhe digjitale , matematikore si dhe të komunikimit.	Mars-Prill 2024	Mësimdhënës dhe drejtues ekipeve dhe departamenteve	Takime të drejtëpërdrejta Pyetësorë Kërkime	Gjetje, sugjerime, materiali përmbledhës kurrikular.	Shkollë

REKOMANDIMI		-Krijimi i materialeve mësimore të mirëfillta për lëndët e teorisë dhe të praktikës profesionale të cilat nuk janë në faqen e AKAFPK.				
Objektivi		<i>-Të realizohen materialet mësimore të mirëfillta për lëndët e teorisë dhe të praktikës profesionale të cilat nuk janë në faqen e AKAFPK</i>				
Treguesi i përmbushjes: Materiali mësimor për çdo lëndë e modul profesional .						
Nr	Veprimtaritë	Afate kohore	Personi përgjegjës	Metodologjia	Instrumenti matës	Vendndodhja
1	Përgatitja me nivel cilësor , shkencor të materialeve mësimore për lëndët e teorisë dhe të praktikës profesionale nga mësimdhënësit përkatës të cilat nuk janë në faqen zyrtare të AKAFPK.	Gjatë vitit 2024	Mësimdhënësit	Punë e pavarur individuale dhe bashkëpunuese në ekip	Materialet e shtypura	Shkollë

REKOMANDIMI		-Përfundimi i Laboratorëve dhe mjediseve të tjera për zhvillimin e praktikave profesionale (Projekti i rindërtimit të GIZ me MFE)				
Objektivi		<i>-Të përfundojnë ndërtimi i laboratorëve dhe mjediseve të tjera për zhvillimin e praktikave profesionale (Projekti i rindërtimit të GIZ me MFE)</i>				
Treguesi i përmbushjes: Shfrytëzimi i ambjenteve për vitin shkollor 2024-2025						
Nr	Veprimtaritë	Afate kohore	Personi përgjegjës	Metodologjia	Instrumenti matës	Vendndodhja
1	Zbatimi i projektit të GIZ & MFE për ndërtimin e ambjenteve të reja të praktikave profesionale dhe pajisjen e tyre .	Shkurt Shtator 2024	Drejtorja e shkollës	Takim	Godinat e reja dhe pajisja e tyre	Shkollë

FUSHA E VETËVLERËSIMIT : Mësimdhënia dhe të nxënit

REKOMANDIMI		-Përmirësimi i vazhdueshëm i punës për hartimin i planit mësimor si kusht i domosdoshëm për arritjen e rezultateve mësimore në mësimdhënie dhe mësimnxënie.				
Objektivi		<i>-Të përmirësohet edhe më tej puna për hartimin i planit mësimor si kusht i domosdoshëm për arritjen e rezultateve mësimore në mësimdhënie dhe mësimnxënie.</i>				
Treguesi i përmbushjes: 80% e mësimdhënësve të jenë të trajnuar .						
Nr	Veprimtaritë	Afate kohore	Personi përgjegjës	Metodologjia	Instrumenti matës	Vendndodhja
1	Orë të hapura mësimore, shkëmbim eksperiencash në të gjitha kualifikimet profesionale	Gjatë vitit Janar – Maj 2024	Drejtorja Njësia Zhvillimit Ekipet lëndore dhe departamentet.mësimdhënësit	Vëzhgim, diskutim	Realizim, kontroll Performanca e lartë në mësimdhënie	Shkollë
2	Trajnim profesional në lidhje me faktorët që ndikojnë në mësimdhënie dhe mësimnxënie	Gjatë gjithë vitit 2024	N/Drejtori Njësia zhvillimit Mësimdhënës	Takime të drejtëpërdrejta	Përmirësimi i cilësisës së mësimdhënësit. Çertifikimi	Shkollë Njësi Zhvillimi Sipas organizimit

REKOMANDIMI		-Zbatimi i fazave dhe i kohës së përcaktuar gjatë orës mësimore për arritjen e rezultateve mësimore në fund të saj.				
Objektivi		<i>-Të përmirësohet edhe më tej puna për hartimin i planit mësimor si kusht i domosdoshëm për arritjen e rezultateve mësimore në mësimdhënie dhe mësimnxënie.</i>				
Treguesi i përmbushjes: 1.Të gjithë mësimdhënësit të jenë të trajnuar. 2. 70% e tyre të zbatojnë atë në mësimdhënie.						
Nr	Veprimtaritë	Afate kohore	Personi përgjegjës	Metodologjia	Instrumenti matës	Vendndodhja
1	Orë të hapura mësimore.	Gjatë vitit Janar – Maj 2024	Drejtorja Njësia Zhvillimit Ekipet lëndore dhe departamentet.mësimdhënësit	Vëzhgim, diskutim	Realizim, kontroll Performanca e lartë në mësimdhënie	Shkollë
2	Biseda , diskutime me mësimdhënësit .	Gjatë gjithë vitit 2024	N/Drejtori Njësia zhvillimit Mësimdhënës	Takime të drejtëpërdrejta	Përmirësimi i cilësisës së mësimdhënësit. Çertifikimi	Shkollë Njësi Zhvillimi Sipas organizimit

REKOMANDIMI		-Në procesin mësimor për mësimdhënësit duhet një thellim e mbështetje më konkrete në parimet kryesore të mësimdhënies gjatë këtij procesi.				
Objektivi		- Të zbatojnë parimet kryesore të mësimdhënies				
Treguesi i përmbushjes: 1. Të gjithë mësimdhënësit të jenë të trajnuar. 2. Të gjithë mësimdhënësit të zbatojnë ato						
Nr	Veprimtaritë	Afate kohore	Personi përgjegjës	Metodologjia	Instrumenti matës	Vendndodhja
1	Trajnim i mësimdhënësve	Gjatë gjithë vitit 2024	Eksperti i brendshëm / jashtëm. Koord. zhvp	Trajnim teorik e demonstrim praktik	Listëprezenca dhe relacioni i trajnimit.	Shkollë Njësi Zhvillimi Sipas organizimit
	Orë të hapura	Janar – Qershor 2024	Mësimdhënësit	Orë e hapur	Relacioni i orës hapur	Klasë Reparti i praktikës

REKOMANDIMI		-Mjetet didaktike e materiale të cilat janë të amortizuara dhe të pamjaftueshme për arritjen e rezultateve mësimore në fund të orës së mësimi.				
Objektivi		-Të plotësojmë ambjentet e teorisë dhe të praktikës profesionale me mjetet didaktike dhe materiale mësimore.				
Treguesi i përmbushjes : Lista e materialeve.						
Nr	Veprimtaritë	Afate kohore	Personi përgjegjës	Metodologjia	Instrumenti matës	Vendndodhja
1	Orë të hapura mësimore, shkëmbim eksperiencash në të gjitha kualifikimet profesionale	Gjatë vitit Janar – Maj 2024	Drejtoria Njësia Zhvillimit Ekipet lëndore dhe departamentet.mësimdhënës	Vëzhgim, diskutim	Realizim, kontroll Performanca e lartë në mësimdhënie	Shkollë
2	Trajnim profesional në lidhje me faktorët që ndikojnë në mësimdhënie dhe mësimnxënie	Gjatë gjithë vitit 2024	N/Drejtori Njësia zhvillimit Mësimdhënës	Takime të drejtëpërdrejta	Listëprezenca e Relacioni i trajnimit	Shkollë Njësi Zhvillimi Sipas organizimit

FUSHA E VETËVLERËSIMIT : Vlerësimi .

REKOMANDIMI		-Përmirësimi i metodave për vlerësimin sa më objektiv të arritjeve të nxënësve.				
Objektivi		-Të përmirësohen edhe me tej metodat për vlerësimin sa më objektiv të arritjeve të nxënësve.				
Treguesi i përmbushjes: Trajnimi i mësimdhënësve të rinj që janë me shkallë kualifikimi III dhe të pakualifikuar .						
Nr	Veprimtaritë	Afate kohore	Personi përgjegjës	Metodologjia	Instrumenti matës	Vendndodhja
1	Orë të hapura mësimore në të gjitha kualifikimet profesionale me fokus: “ Metodatat e vlerësimit të nxënësve”	Gjatë vitit 2024	N/Drejtori shkollës Departam, entet dhe ekipet lëndore	Vëzhgim, diskutim Pyetesore Intervista	Relacion i hapur	Klasa, Laboratore. reparte
2	Trajnim i mësimdhënësve	Shkurt-Maj 2024 2024	Ekspert i brendshëm / i jashtëm	Trajnim teorik, demonstrim praktikë	Listëprezencë	Shkollë

Ekipi përgjegjës i vetëvlerësimit

Kryetari
Nazmi Kasmi

Anëtare
Mimoza Zhamo

Anëtare
Manjola Sharkaj